



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr. 334/2019

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Gyltene Sylejmani kryesuese, Faton Ademi dhe Adnan Konushevcu anëtarë, me pjesëmarrjen e zyrtares së lartë ligjore Florije Krasniqi, duke vendosur përkitazi me ankesën e vëzhguesit Kastriot Hetemi nga radhët e subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), paraqitur kundër komisionerëve të vendvotimit 1217B/01D, për shkak të parregullsive në ditën e votimit për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvend të Republikës së Kosovës, në seancën e panelit të mbajtur me 08.10.2019, mori këtë:

V E N D I M

HUDHET si e palejuar ankesa A.nr 334/2019 të datës 07.10.2019, të parashtruar nga vëzhguesi Kastriot Hetemi, nga radhët e subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK),

A r s y e t i m

PZAP-i, me datë 107.10.2019, ka pranuar një ankesë Anr.334/2019 nga Kastriot Hetemi vëzhguesi i subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), nga Komuna e Leposaviqit, në të cilën pretendohet se rreth orës 12:00 në vendvotimin me nr. 1217B/01D, kryesuesi dhe komisionarët e këtij vendvotimi, nuk i kanë udhëzuar në mënyrë të rregullt votuesit të cilët kane votuar me kusht në këtë vendvotim.

PZAP-i, pasi që shqyrtoi lejueshmërinë e ankesës, gjeti se:

Ankesa është e palejuar

PZAP-i, konstatoi se ankesa është e palejuar ngase rezultati preliminar nuk është shpallur nga KQZ-ja dhe se mund të ndryshoj në çdo moment, po ashtu Qendra e Numërimit dhe Rezultateve QNR ende është në fazën e procedimit të materialeve zgjedhore nga Qendrat e Votimit. Andaj rezultati zgjedhor nuk ka marrë formën përfundimtare, në momentin e shpalljes së rezultateve përfundimtare të QNR-së palët e pakënaqura në pajtim me nenin 105 të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme mund të ushtroj ankesën në afatin prej 24 orëve.

Bazuar në arsyet e sipërshënuara dhe në kuptim të Nenit 118.1 të LZP-së i cili parasheh se “PZAP-i, pranon ankesat e bazuara në fakte dhe refuzon ankesat të cilat nuk i përmbushin standardet” dhe Nenit 6.4 të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it, në të cilin përcaktohet se: “Ankesat të cilat janë të palejuar dhe të pasafatshme PZAP-i i hudhë poshtë me vendim”, lidhur me ankesën e lartë përmendur vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
A nr. 334/2019 më datën 08.10.2019

Kryesuese e Panelit
Gyltena Sylejmani



Këshillë juridike: *Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa.*